



## Free Libre Open Source Software Kosova

---

Rr. "Hajdar Dushi" Blloku B, #11, Prishtinë 10000 | [info@flossk.org](mailto:info@flossk.org) | [www.flossk.org](http://www.flossk.org)

20 janar 2015

**Për:** Znj. Teuta Sahatqija  
Kryetare  
Komisioni Parlamentar për Integritim Evropian

**Për dijëni:** Z. Kadri Veseli  
Kryetar i Kuvendit  
Kuvendi i Kosovës

**Tema:** Projektligji për përgjimin e komunikimeve elektronike

E nderuar znj. Sahatqija,

Unë jam një anëtar i bordit ekzekutiv në OJQ-në FLOSS Kosova, një organizatë e cila mes tjerash merret me promovimin e privatësisë në komunikimet elektronike.

Kemi përcjellur me vëmendje procesin e krijimit të Projektligjit për përgjimin e komunikimeve elektronike dhe kemi shqetësime si për nga ana procedurale, ashtu edhe për nga ajo përmbajtore.

Ky projektligj prek disa të drejta themelore dhe parime bazë të drejtësisë të mbrojtura me Kushtetutë dhe ligje, si e drejta e qytetarëve për privatësi (neni 36 i Kushtetutës), nevoja për dyshim të bazuar për ndjekje, dhe e drejta e mbrojtjes së burimeve në gazetari.

Përgjimi masiv, kështu siç është propozuar me këtë projektligj, do të prekë edhe konfidencialitetin e një sërë relacionesh të cilat mbrohen me ligj: e avokatëve me klientët, e mjekëve me pacientët, e deputetëve me qytetarët, e klerikëve me besimtarët apo sekretet biznesore.

Për më tepër, Kushtetuta e Kosovës ka një nen të plotë që i kushtohet privatësisë. Neni 36.3 i Kushtetutës thotë: *"Fshehtësia e korrespondencës, telefonisë dhe komunikimit tjetër, është e drejtë e pacenueshme. Kjo e drejtë mund të kufizohet vetëm përkohësisht, në bazë të vendimit gjyqësor, nëse është e domosdoshme për ecurinë e procedurës penale ose për mbrojtjen e vendit, në mënyrën e parashikuar me ligj."*

## Konsultimi publik

Së pari, kemi një ankesë procedurale. Vetëm një numër i vogël nga shoqëria civile është përfshirë në konsultimin publik, përkundër faktit që kjo fushë prek të drejtat themelore të njeriut, dhe përkundër kërkesës për t'u përfshirë në këtë proces. Draftet e dërguara për konsultim publik asnjëherë nuk janë publikuar për publikun e gjerë ashtu siç e kërkon Neni 32 i Rregullores 9/2011 të Punës së Qeverisë së Kosovës. Për më tepër, me propozimin legjislativ, Qeveria e Kosovës nuk ka dorëzuar për Deputetët e Kosovës rezultatet e procesit të konsultimit, të cilat kërkohen të jenë pjesë përbërëse e koncept-dokumentit ose memorandumit shpjegues (po aty).

## Mbajtja e përgjithshme e të dhënave

Më 8 prill 2014, përmes vendimit në rastet e bashkuara C-293/12 dhe C-594/12<sup>1</sup>, Gjykata e Drejtësisë e Bashkimit Evropian ka shpallur të pavlefshme në plotëni Direktivën 2006/24/EC për mbajtjen e të dhënave (termi “ruajtje” që përdoret në projektligj nuk është më i sakti i mundshëm). Kjo Direktivë ka qenë shtyllë e projektligjit (*Neni 12 – Kategoritë e të dhënave që duhet ruajtur*).

Gjykata thekson se kërkesa për të mbajtur të dhënat dhe pastaj për t'i vënë ato në dispozicion për autoritetet kombëtare “ngre pyetje në lidhje me respektimin e jetës private dhe të komunikimit në bazë të nenit 7 të Kartës [së BE-së për të Drejtat Themelore], mbrojtjen e të dhënave personale sipas nenit 8 të Kartës dhe të respektimit të lirisë së shprehjes në bazë të nenit 11 të Kartës“ (para 25).

Në vendim, Gjykata, duke iu referuar Direktivës, thekson se ajo, “së pari, mbulon në mënyrë të përgjithësuar të gjithë personat dhe të gjitha mjetet e komunikimit elektronik si dhe të gjitha të dhënat e komunikimit pa ndonjë dallim, kufizim ose përjashtim duke u bërë në dritën e objektivit të luftës kundër krimeve të rënda” (para. 57). Pastaj, “Mbi të gjitha, qasja nga autoritetet kompetente kombëtare në të dhënat e pashpërndara nuk bëhet e varur nga një rishikim paraprak i kryer nga një gjykatë ose nga një organ i pavarur administrativ vendimi i të cilit kërkohet për të kufizuar qasjen në të dhënat dhe përdorimin e tyre për sa është e domosdoshme me qëllim të arritjes së qëllimi të synuar dhe i cili ndërhyr pas një kërkesë të arsyetuar të këtyre autoriteteve të paraqitura në kuadrin e procedurave të parandalimit, zbulimit apo ndjekjeve penale” (para. 62).

Gjykata e citon deklaratën e Avokatit të Përgjithshëm: “Fakti që të dhënat ruhen dhe pastaj përdoren pa pajtimin ose informimin e përdoruesit të regjistruar ka gjasa të krijoj në mendjen e personave në fjalë një ndjenjë se jeta e tyre private është subjekt i mbikëqyrjes të vazhdueshme” (para. 37). Keni parasysh që Gjykata po adreson vetëm metatëdhënat (p.sh. kohën e dhirrjeve telefonike, kohëzgjatjen etj.) në këtë rast. Gjykata vlerëson se duke adoptuar Direktivën, “legjislativi i BE-së ka tejkuluar kufijtë që imponon parimi i proporcionalitetit“ (para. 69). Me këtë mund të përfundohet se vëzhgimi i përgjithshëm i qytetarëve të padyshuar për krime të rënda pa autorizim të Gjykatës nuk është as i nevojshëm e as proporcional.

Ashtu siç edhe thuhet shpesh nga vet BE-ja, Kosova ka probleme me sundimin e ligjit dhe kontrollin demokratik të ekzekutivit nga Kuvendi<sup>2</sup>. Standardi shumë i diskutueshëm i BE-së për përgjimin masiv, tanimë i hedhur poshtë, bëhet edhe më i diskutueshëm në Kosovë ku standardet e kontrollit demokratik dhe gjyqësorit nuk janë arritur paralelisht.

Megjithatë, projektligji para jush vazhdon të kërkoj mbajtjen e të dhënave për të gjithë qytetarët e Kosovës pa përjashtim (tash me referencë të fshirë), duke paragjykuar kështu fajësinë e qytetarëve. Një

1 <http://eur-lex.europa.eu/legal-content/EN/TXT/HTML/?uri=CELEX:62012CJ0293&rid=1>

2 [http://ec.europa.eu/enlargement/pdf/key\\_documents/2014/20141008-kosovo-progress-report\\_en.pdf](http://ec.europa.eu/enlargement/pdf/key_documents/2014/20141008-kosovo-progress-report_en.pdf)

interpretim i shërbimit ligjor të Parlamentit Evropian të këtij vendimi i cili kërkon të shpjegoj mënyrën se si deputetët duhet t'i qasen ligjvënies në fushën e përgjimit, konsideron që çfarëdo masë e përgjimit duhet të bëhet pas një studimi të proporcionalitetit dhe nevojshmërisë së masës së propozuar<sup>3</sup>. Qeveria e Kosovës, si propozuese e këtij drafti, nuk ka dhënë kurrfarë evidence të këtillë në dokumentacionin që ka dorëzuar para jush.

Për më tepër, ka arsye të besueshme se përgjimi masiv jo vetëm që nuk është efektiv<sup>45</sup> në luftimin e terrorizmit, por edhe mund të vështirësoj atë për shkak të rritjes së proporcionit mes zhurmës dhe sinjalit. Sidoqoftë, duke marrë parasysh shkeljen masive të privatësisë, i mbetet Qeverisë të na dëshmojë të kundërtën.

## **Njësitë ndërlidhëse**

Problemi tjetër madhor me këtë projektligj është se AKI-ja do të krijoj një njësi ndërlidhëse që do të mundësojë lidhjen direkte të saj me operatorët për t'i mundësuar përgjimin. Ndërsa projektligji kërkon urdhër të gjykatës edhe për AKI-në, përmes njësisë së tyre ndërlidhëse, AKI-ja do të ketë lirinë e pakontrolluar të veprimit. Ligji bën thirrje për dy lloje të zgjidhjeve elektronike: *qendrat monitoruese*, të vendosura në institucionet e autorizuara të cilët do të marrin informacionin për të cilën janë autorizuar përmes urdhrit të gjykatës, dhe *njësitë ndërlidhëse* të vendosura në kompanitë e komunikimit që do t'i shërbejnë të parat. Por AKI-ja gjithashtu lejohet të ketë një nga këto njësitë ndërlidhëse në objektin e tyre. Kjo është e papranueshme pasi nuk ofron asnjë mjet për të kontrolluar kundër abuzimit dhe praktikisht i jep Agjencisë një mundësi të pakufizuar për të përgjuar. Për më tepër, projektligji gjithashtu kërkon që operatorët e komunikimeve të mundësojnë qasjen në informata të pa-enkriptuara. Kur kësaj i shtohet edhe fakti që të gjitha detajet teknike të zbatimit as që janë të përcaktuara (edhe pse ato do të specifikohen më vonë me ligje sekondare), mundësitë për abuzime shtohen jo vetëm brenda AKI-së por edhe jashtë saj. Madje, një analize e kapaciteteve vendore për zbatimin teknik të këtyre ndërfaqeve në mes operatorëve dhe AKI-së, mesiguri që do të na shtonte brengat për zbatimin pa kompromise teknike që do të mundësonin abuzime jashtë-institucionale.

## **Institucionet e autorizuara**

Projektligji nuk kufizon "ligjet e veçanta" që mund të përdoren për lëshimin e urdhrit për përgjim me bazë këtë projektligj. Kjo do të thotë se në qoftë se ligji miratohet këtë formë, vëmendje e përhershme do të jetë e nevojshme për të siguruar që institucionet e tjera nuk do të marrin qasje nëpërmjet ligjeve të tjera .

## **Njoftimi për përgjim**

Projektligji i referohet Kodit të Procedurës Penal dhe Ligjit të AKI-së si dy prej bazave ligjore për marrjen e urdhrit. Përderisa Kodi Penal ka konceptin e të drejtës së qytetarëve të përgjuar për t'u informuar kur ky përgjim nuk i shërben më ndjekjes, ligji i AKI-së nuk e ka. Prandaj, asnjë qytetar nuk do të mund ta dijë se ata kanë qenë të mbikëqyrur nga AKI-ja, pasi që përveç rasteve kur ndryshe lejohet shprehimisht me një ligj tjetër, njoftimi është i ndaluar me këtë projektligj.

---

3 <https://www.accessnow.org/blog/2015/01/07/leaked-european-parliament-long-awaited-legal-study-on-data-retention>

4 <http://www.newscientist.com/article/dn26801-mass-surveillance-not-effective-for-finding-terrorists.html>

5 <http://www.bloomberg.com/news/2014-01-13/nsa-data-has-no-discernible-impact-on-terrorism-report.html>

Siç është gjykuar nga Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut<sup>6</sup>, njoftimi është një e drejtë, prandaj projektligji është në shkelje të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, të cilën Kosova përmes Kushtetutës e zbaton në mënyrë të drejtpërdrejtë dhe mbisunduese ndaj akteve të saj, por nga ana tjetër qytetarët e saj ende nuk mund t'i drejtohen Gjykatës për shkak se Kosova nuk ka aderuar në Konventë.

### **Asistenca në Përgjim (neni 9)**

"Bazuar në një hetim të ligjshëm, në përputhje të plotë me Kodin e Procedurës Penale të Kosovës" projektligji lejon për shkeljen e anonimitetit të një qytetari duke kërkuar identitetin e një caku në përgatitje për përgjim. Tërthorazi, ky nen thekson se urdhri i gjykatës nuk do të jetë i nevojshëm për këtë procedurë. Për më tepër, parimi i njoftimit shkelet edhe një herë me këtë nen pasi që njoftimi është i ndaluar shprehimisht.

### **Regjistrimet e përgjimeve (nenet 11 dhe 13)**

Nuk ka mënyrë për të kontrolluar zbatueshmërinë e këtij neni në rastin e AKI-së për shkak se askush nuk do të mund të dijë saktë se sa raste i ka përgjuar kjo Agjenci.

Në kërkesat e raportimit, nuk kërkohet të përcaktohet efektiviteti dhe domosdoshmërinë e të dhënave të shpërndara për të luftuar krimin, por vetëm për aftësinë për të ofruar të dhëna. Efektiviteti dhe domosdoshmëria janë bazë për të vlerësuar arsyeshmërinë e ligjeve të cilat cenojnë të drejtat e qytetarëve.

### **Ndëshkimet (neni 15)**

Për shkelje të mos-përmbushjes, një operator rrjeti ose ofrues i shërbimit mund të ndëshkohet me një dënim prej të paktën 86.000 euro dhe deri në 7% të të ardhurave vjetore nga aktiviteti i tyre ekonomik në komunikimin elektronik. Por nuk ka dënime të parapara për shkeljet që dëmtojnë jetën private të qytetarëve, duke favorizuar në mënyrë të qartë ndarjen e të dhënave të qytetarëve me autoritetet. Për shkeljet, ky projektligj vendos standarde të dyfishta. Parashih dënime substanciale vetëm për operatorët për shkeljet që dëmtojnë sigurinë kombëtare por kërkon vetëm masa standarde të sigurisë dhe nuk parashih ndëshkime për shkelje që cenojnë privatësinë e qytetarëve të cilat mund të jenë rrjedhojë edhe e standardeve që do t'i përcaktoj AKI-ja.

### **Transparenca e softuerit**

Ligji nuk parashih publikimin e kodit për të siguruar që pajisjet do të jenë në shërbim vetëm të palëve të autorizuar. Gjatë viteve 2004-2005 është zbuluar që një palë e panjohur ka instaluar softuer të përgjimit në një central telefonik në Greqi duke përgjuar telefonat e rreth 100 zyrtarëve të lartë grek<sup>7</sup>, duke përfshirë kryeministrin dhe shumë ministra. Kush do të siguroj që softueri i instaluar për përgjim të ligjshëm nuk do të kontrollohet nga palë të paautorizuara?

Duke krijuar interfejsa (ndërfaqe) të ri paralel e të pakontrollueshëm të qasjes në komunikime ky ligj e rritë ekspozimin ndaj ndërhyrjeve të jashtme, por në të njëjtën kohë i lejon operatorët të operojnë me praktikat standarde të sigurisë. AKI-ja përmes të drejtës për t'i bërë përzgjedhjet teknike do të ketë

6 Shiko diskutimin e rasteve relevante të kësaj Gjykate për çështjen e njoftimit këtu <http://ejlt.org//article/view/155/264>. Neni 53 i Kushtetutës së Kosovës kërkon që të drejtat njeriut dhe liritë themelore të garantuara me këtë Kushtetutë të interpretohen në harmoni me vendimet gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

7 Diskutim i incidentit në Wikipedia [https://en.wikipedia.org/wiki/Greek\\_wiretapping\\_case\\_2004-05](https://en.wikipedia.org/wiki/Greek_wiretapping_case_2004-05)

mundësinë të përcaktoj standard më të ulëta në favor të saj dhe palëve të treta.

## **Përfundime**

Duke konsideruar që e drejta për privatësi është e drejtë themelore e mbrojtur me Kushtetutën e Kosovës, kërkojmë që:

- Duke marr parasysh mes tjerash vendimin e GJDBE-së, të hiqet mbajtja e përgjithshme e të dhënave si jo-proporcionale me qëllimet. Për çdo masë të propozuar të përgjimit të merren parasysh standardet e vendosura me nenin 55 të Kushtetutës dhe ato të cilat i ka vendosur Gjykata e Drejtësisë e BE-së siç janë interpretuar nga shërbimi ligjor i Parlamentit Evropian, për të kërkuar nga Qeveria e Kosovës evidencë dhe studim të proporcionalitetit dhe nevojshmërisë së masave të propozuara, nën hijen e efektivitetit të masave të ngjashme në vendet tjera, për të siguruar nivel të lartë të mbrojtjes së të drejtave të qytetarëve në përputhje me kontekstin e zhvillimit demokratik e ligjor të Kosovës.
- Regjistrat e përgjimeve të raportuara publikisht në periudha vjetore të përdorën për të gjykuar nga publiku efektivitetin e masave të adoptuara dhe përligjur çfarëdo cenimi të nevojshëm të privatësisë.
- Të hiqet interfejsi paralel për përgjim për AKI-në sepse kjo efektivisht do të thotë qasje e pakontrolluar për këtë organizatë.
- Të hiqet referenca në ligjet e veçanta.
- Shkeljes së privatësisë së qytetarëve t'i jepet e njëjta peshë me dëmin që mund t'i shkaktohet hulumtimit të krimeve dhe sigurisë publike.
- Njoftimi pas ndjekjes të obligohet edhe për AKI-në.
- Anonimiteti është poashtu privatësi dhe nuk duhet të shkelet pa urdhrin e gjykatës.
- Për shkak se do të hapen vektor të ri të sulmit, zgjidhjet teknike për mbrojtjen e privatësisë së qytetarëve duhet të jenë më të larta se ato të zakonshmet që përdorën nga operatorët.
- Standardet e sigurisë të vendosen nga një organizatë e tretë si ARKEP e cila ka kapacitetin teknik për t'i kuptuar problemet dhe në transparencë të plotë ndaj publikut. Softueri të jetë i hapur për të siguruar që bënë atë për të cilin është dedikuar.

Mbetëm në dispozicionin e Komisionit tuaj për t'i diskutuar këto çështje më gjerësisht.

Me nderime,

Arianit Dobroshi

Anëtar i bordit ekzekutiv  
+377 44 905 647  
arianit.dobroshi@flossk.org